

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. Nr. Prot. 1624
Org. Jedin. Org. Unit Prot. No:
Nr. i faqeve Data 22.09.2020
Drej. Stronico Datum
No. pages: Date:
Dallëse PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Numër: 01/2020
Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të vendimit Nr. 92/2020, datë 10.09.2020 Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme në takimin e mbajtur me datë 18.09.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Vazhdohet deri më 31 Dhjetor 2020 angazhimi i Sekretarisë për të asistuar Këshillin Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme (KMLVPP).
2. Gjatë periudhës së vazhduar sipas pikës një (1) të këtij vendimi Sekretaria do të përmbush detyrat dhe përgjegjësit e caktuara me Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret e Licencimit të Personave Fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme e miratuar me vendimin me numër protokoli 456, datë 25.09.2012.
3. Sekretaria do të veproj në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës deri më datën sipas pikës një (1) të këtij vendimi.
4. Sekretaria do të përmbush gjithashtu çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër që i caktohet nga Këshilli.
5. Për punën e bërë, Sekretaria i raporton Këshillit në çdo muaj.
6. Kompensimi i anëtarëve të Sekretarisë bëhet nga fondi i mjeteve në dispozicion të grumbulluara nga pagesat e bëra nga personat e licencuar si vlerësues të pronave të paluajtshme për procedurat e ndjekura.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Bazuar në ndryshimet e ndodhura pas shfuqizimit të vendimeve për themelimin e Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme sipas Vendimit nr. 61/2020 dhe caktimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme me Vendimin e MF nr. 92/2020, sipas nenit 17, paragrafi 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Deri në funksionalizimin e plotë të Këshillit të ri në funksion të adresimit të kërkesave në proces për shkak të nevojës së kalimit përmes fazës së tranzicionit nga organizimi dhe funksionimi i deritashëm në organizimin e ri, duke marr parasysh rolin dhe rendësin që ka Sekretaria në asistimin e Këshillit, Këshilli ka vendosur sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi i'u dërgohet:
Anëtarëve të Këshillit;
Sekretarisë së Këshillit; dhe
Arkivit të MF-së;

Agron THAÇI

Kryesues i Këshillit

